



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr.313/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12.2 shkronja (d), 40, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2024 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E KODIT TË ETIKËS DHE MIRËSJELLJES –KOMUNA HANI I ELEZIT

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për Kodin e Etikës dhe Mirësjelljes – Komuna Hani i Elezit.
2. Kodin e Etikës dhe Mirësjelljes përmban gjithsej 16 (gjashtëmbëdhjetë) faqe dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria e Administratë,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:30.01.2024



Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 314/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 53 pika 3, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2024 merr:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT ME NUMËR 01/6387/2022

1. Kuvendi i komunës miratoi vendim për shfuqizimin e vendimit për planin komunal për integritet me numër 01/6387/2022 i datës 30.08.2022.
2. Shfuqizimi i këtij vendimi bëhet pas pranimit të vendimit me numër 01/Nr.1476/23 nga Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja e Administratës,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:30.01.2024

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 315/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, neni 11, 40, Rregulloren për Organizimin, Funkionimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit 01/Nr.9274/2019, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30. 01. 2024 merr:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KËSHILLAVE TË FSHATRAVE TË KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITIN 2024

1. Kuvendi i Komunës miratoi vendimin për planin e punës së këshillave lokale në Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2024.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plani i punës së këshillave lokale në Komunën e Hanit të Elezit për vitin 2024.
3. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendimi njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtorja e Administratës,
- Këshillat lokale të Komunës së Hanit të Elezit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data: 30. 01. 2024

Kryesuesi i Kuvendit
Florim Shkreta



01/ Nr.316/ 2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11 , 40, Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal numër Nr.03/L-049 neni 2, dhe në bazë të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me numër 01/Nr.2821/ 2022 të datës 31.05.2022 neni 14, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30. 01. 2024 merr:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR BURSA PËR STUDENTËT E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

1. Kuvendi i komunës miratoi vendimin për ndarjen e mjeteve financiare për bursa për studentët në Komunën e Hanit të Elezit për vitin akademik 2023/2024.
2. Mjetet financiare të cilat do të dedikohen për ndarjen e bursave për studentë merren nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere vlera e të cilave është në shumë prej 20,000.00 €, që do të përfitojnë 40 (katërdhjetë) studentë për dhjetë muaj nga 50.00 € në muaj.
3. Prioritetet për quadro deficitare janë në Fakultetet:

Fakulteti i Mjekësisë (Mjekësi e Përgjithshme, Stomatologji).

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (Konstruksioneve, Hidroteknikës, Gjeodezisë, Inxhinierisë së Ambientit, Arkitekturë dhe Eficiencë e Energjisë).

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (Inxhinieri Kompjuterike, Telekomunikacion, Elektronikë, Automatikë, Sistemet Elektroenergjetike, Elektroenergjetikë Industriale).

Fakulteti i Edukimit (Matematikë, Fizikë, Kimi, Biologji dhe TIK)

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike (Prodhimtari dhe Automatizim, Termoenergjetikë dhe termoteknikë, Konstruksione dhe mekanizim, Komunikacion).

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë (Agroekonomi, Bioteknologji në Zooteknik, Lavërtari – Perimtari, Mbrojte e Bimëve, Pemëtari – Vreshtari, Veterinari, Bioteknologji Ushqimore).

Fakulteti i Xehetarisë dhe Metalurgjisë (Xehetarisë, Gjeologjisë, Materiale dhe Metalurgji, Teknologjisë).

Fakulteti i Shkencave Matematikë – Natyrore (Matematikë, Fizikë dhe Kimi).

Fakulteti Arteve

Fakulteti Filologjik (Gjuha Angleze, Gjuha Gjermane).

4. Bursat ndahen për studentët e vitit të dytë e lartë. Në rast të mos plotësimit të bursave nga viti i dytë e lartë, plotësohet sipas rregullores për ndarjen e bursave edhe për vitin e parë të studimeve.

Përzgjedhjen e kandidatëve do ta bëjë komisioni i formuar nga drejtoria për arsim, sipas rregullores për ndarje të subvencioneve.

5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria e Arsimit,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data: 30.01.2024

